

FAMILJET ROME DHE EGJIPTIANE FITOJNË ÇËSHTJEN E RËNDËSISHME MBI SHKOLLAT E SEGREGUARA PËRPARA GJYKATËS EUROPIANE



Image: ATA Agjencia Telegrafike Shqiptare

Bruksel, 31 Maj 2022: Familjet nga pakicat Rome dhe Ballkano-Egjiptiane kanë fituar një çështje përpara Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECtHR) e cila potencialisht do të krijojë një precedent kundër qeverisë Shqiptare lidhur me segregimin për shkak të racës në shkollën Naim Frashëri në Korçë. Gjykata doli në përfundim se Shqipëria ka dhunuar nenin 1 të Protokollit 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ka dështuar në zbatimin e masave për ç'segregimin e plotë dhe gjithëpërfshirës të shkollës 9-vjeçare e cila frekuentohej pothuajse ekskluzivisht vetëm nga fëmijë Rom dhe Ballkano-Egjiptian. Sipas gjykimit, qeveria Shqiptare duhet të marrë të gjitha masat për të ç'segreguar shkollën, si dhe të paguajë dëmin në masën e 4,500 Euro për secilën familje të prekur nga ky fenomen. Familjet ishin të përfaqësuar nga Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (ERRC) e cila e solli çështjen deri në Strasburg, duke kaluar gjykatat e brendshme të vendit pasi që autoritetet publike dështuan në ç'segregimin e shkollës.

“Qasja e barabartë në arsim është një nga faktorët më të rëndësishëm për të garantuar barazi dhe për ti dhënë fund trashëgimisë së retorikës kundër romëve ose siç njihet më gjerë me termin antigypsyism, u shpreh Drejtoresha për Çështjet Ligjore në ERRC, Vivien Brassói. ‘Vendimi nga Gjykata Evropiane është i qartë: Autoritetet shtetërore duhet medoemos të respektojnë vendimet e mekanizmave për barazi dhe të marrin masat e menjëhershme për të ndryshuar situatën. Ne përgëzojmë familjet të cilat e sollën këtë çështje dhe shënuan një moment historik në fushën e ligjit, jo vetëm në Shqipëri por në të gjithë Evropën.’”

Vendimi përsëriti nenin 46 to Konventës e cila ushtron detyrimin ligjor mbi shtetin Shqiptar për t'i dhënë fund shkeljes dhe dhunimit të ligjit të konstatuar nga Gjykata Evropiane (në rastin konkret, shkolla të segreguara për shkak të diskriminimit) dhe të ofrojë korrigjimin si dhe kompensimin, sa më shumë të jetë e mundur, e pasojave për qytetarët e prekur nga diskriminimi. Qeveria Shqiptare ka tre muaj kohë për të paguar shumën prej 22,500 Euro, përfshirë edhe taksat përkatëse, në llogari të familjeve të prekura nga diskriminimi dhe segregimi në shkollë.

Shkolla Naim Frashëri ndodhet e pozicionuar në periferi të qytetit të Korçës dhe është e njohur ndryshe si 'shkolla e Romëve dhe Egjiptianëve', për arsye se gati, për të mos thënë, të gjithë studentët që frekuentojnë këtë shkollë i përkasin dy pakicave kombëtare Rome dhe Egjiptiane. Ajo çka dikur ishte një shkollë e integruar dhe e frekuentuar nga një larmishmëri nxënësish Rom, Egjiptian dhe Shqiptar, filloi të shndërrohet në shkollë e segreguar që nga viti 2012, sepse gjithnjë e më shumë, prindërit Shqiptar filluan t'i hiqnin fëmijët e tyre nga kjo shkollë duke parë rritjen e vazhdueshme të numrin të Romëve dhe Ballkano-Egjiptianëve në këtë shkollë (ky fenomen njihet si *white flight*, ose *fluturimi i bardhë*, që nënkupton emigrimin e papritur dhe gjithnjë e më rritje të bardhëve nga zonat që bëhen gjithnjë e më shumë shumë-etnike dhe shumë-kulturore). Brenda pak vitesh, shkolla frekuentohej nga gati 99% nxënës Rom dhe Egjiptian. Ndërkohë që, prindërit e tyre vunë re se cilësia e arsimit që fëmijët merrnin përkeqësohej, madje, disa nga fëmijët nuk ishin në gjendje të shkruanin dhe lexonin.

Pasi takuam me disa nga prindërit nga kjo shkollë, ERRC përgatiti një ankesë në emër të organizatës dhe ia drejtoi Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili pranoi se ky segregim racor është i kundërligjshëm. Më 14 Prill 2017, Ministria e Arsimit përgatiti një shkresë duke parashtruar të gjitha hapat që Qeveria do të ndërmerre për të ç'segreguar shkollën. Megjithatë, asnjë hap nuk u ndërmor nga autoritetet vendore për ç'segregimin e shkollës Naim Frashëri, apo të shkolla të tjera të segreguara.

Prindërit e fëmijëve u takuan me ERRC-në nga fundi i 2017, pasi kishte filluar edhe një tjetër vit shkollor ku fëmijët e tyre po frekuentonin sërish një shkollë në kushte të segreguara. Ata ishin të pakënaqur që autoritetet përkatëse nuk morën masat sikurse prematuan për të ç'segreguar shkollën. Në vend që të prisnin me vite nga sistemi i gjykatave Shqiptare për të proceduar çështjen (kohë gjatë së cilës fëmijët e tyre do vazhdonin të ishin të segreguar), ne i këshilluam që t'i drejtoheshim drejtpërdrejtë Gjykatës Evropiane. Duke qenë se autoritetet e kishin njohur dhe pranuar problemin, prematuan ta ç'segregonin, dhe nuk bënë pothuajse asgjë, adresimi i çështjes së brendshme do të ishte humbje kohe. Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve e adresoi çështjen drejtpërdrejtë pranë Gjykatës Evropiane përmes dy aplikimeve: Aplikimi i parë në tetor 2017, me numër. [73548/17](#) dhe aplikimi i dytë në Gusht 2019, me numër [45521/19](#). Ankesa kishte në thelb segregimin diskriminues të shkollës përkundrejt Protokollit 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për më shumë informacion, ose për të caktuar një intervistë jeni të lutur të na kontaktoni:

Jonathan Lee (in English)
Advocacy & Communications Manager
European Roma Rights Centre
jonathan.lee@errc.org
+32 49 288 7679

Manjola Veizi (in Albanian)
Legal Consultant
European Roma Rights Centre
manjola.veizi@errc.org
+35 569 694 80 40

Informacion kontekstual:

Protokolli Nr. 12 është një garanci për të drejtat e njeriut nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut tek e cila ka nënshkruar edhe shteti Shqiptar. Çdo njeri në Shqipëri është i mbrojtur nga diskriminimi mbi bazë të racës, etnisë ose ngjyrës nga çfarëdo autoriteti publik ose çdo e drejtë e mbrojtur nga ligji. Jo të gjitha shtetet e Evropës kanë rënë dakord për t'u lidhur pas dispozitave të Protokollit Nr. 12, por Shqipëria i ka nënshkruar dhe rënë dakord për t'i respektuar. ERRC-ja iu shpreh Gjykatës Evropiane që kjo krijon detyrime të forta dhe të drejtpërdrejta për Shqipërinë që t'i japë fund segregimit të shkollave dhe formave të tjera të diskriminimit.